REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr5734 Prot

Maliq, më 28.09.2026

VENDIM

Nr 116, datë 28.09.2026

"Për shqyrtimin e kërkesës për rishikimin e strukturës dhe bonitetit të tokës për pasuritë në pronësi të shoqërisë *"TOPTANI CSE"*

Në mbështetje të ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 *"Për vetqeverisjen vendore "*, i ndryshuar, të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1 nënpika 1.1 germa "b", ligjin 8752 datë 26.03.2001 *"Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin e mbrojtjen e tokës"* si dhe në referim të Vendimit nr. 121, datë 17.02.2011, *"Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komuna dhe bashki"*, bazuar në kërkesën e shoqërisë *"TOPTANI CSE"*, relacionin e Sektorit të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe verifikimin e kryer në terren, këshilli i bashkisë,

VENDOSI :

1. Këshilli i Bashkisë Maliq të shqyrtojë kërkesën e shoqërisë *"TOPTANI CSE"*, me NIPT M52206071A, për rishikimin e strukturës dhe bonitetit të tokës për pasuritë e mëposhtme:

Pasuria	Lloji	ZK	Kodi unik	Sipërfaqja	Vendndodhja
3/8/13	Arë	1886	1886007077	100,000 m²	Gurabardhë, Korçë
3/8/12	Arë	1886	1886007076	204,085.2 m²	Gurabardhë, Korçë

2. Të merret në konsideratë gjendja faktike e konstatuar gjatë verifikimit në terren, ku janë evidentuar shenja dëmtimi dhe degradimi të tokës, të lidhura kryesisht me erozionin, gërryerjen dhe problematikat e mosfunksionimit të kanaleve të ujërave të larta.
3. Të merret në konsideratë edhe fakti i evidentuar në dokumentacion se sipërfaqja nuk është shfrytëzuar për një periudhë më shumë se 30 vjet, si rrethanë që duhet të vlerësohet gjatë shqyrtimit teknik.
4. Të propozohet përcjellja e kërkesës, relacionit, procesverbalit të verifikimit në terren dhe dokumentacionit shoqërues pranë DAMT, Qarku Korçë, për shqyrtim teknik dhe vijimin e procedurave në kompetencë të saj.
5. Të autorizohet struktura përgjegjëse e Bashkisë Maliq që të bashkëpunojë me strukturën kompetente dhe të vërë në dispozicion dokumentacionin apo informacionin shtesë që mund të kërkohet gjatë shqyrtimit të çështjes.
6. Të theksohet se propozimi nuk parapërcakton kategorinë apo bonitetin e ri të

tokës.Çdo ndryshim i strukturës dhe bonitetit do të bëhet nga struktura kompetente, në përputhje me procedurat dhe kriteret ligjore në fuqi.

7. Për zbatimin e këtij propozimi, pas miratimit nga Këshilli Bashkiak, të ngarkohet struktura përgjegjëse për bujqësinë dhe administrimin e dokumentacionit të tokës në Bashkinë Maliq.
8. Ky vendim hyn ne fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar.

Miratuar me 19 vota
Vota Pro 19
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 1
Zbardhur me datë 28.09.2026

KRYETARI I KËSHILLIT
Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ